




**USAID**

NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

# Vlerësimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit: Shqyrtim dhe rekomandime gjashtëmujore (korrik - dhjetor 2023)





# Vlerësimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit: Shqyrtim dhe rekomandime gjashtëmujore (korrik - dhjetor 2023)

## Aktiviteti i USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës

**DEKLARATË MOHUESE:** Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

# Lista e shkurtesave

- AK** → Autoriteti Kontraktues
- D+** → Demokraci Plus
- GOE** → Grupi i Operatorëve Ekonomikë
- LPP** → Ligji për Prokurimin Publik
- MM** → Ministria e Mbrojtjes
- MMPHI** → Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- MSh** → Ministria e Shëndetësisë
- OE** → Operatori Ekonomik
- OSHP** → Organi Shqyrtues i Prokurimit
- SML** → Sistemi për Menaxhimin e Lëndëve

# Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	4
Përmbledhje ekzekutive.....	6
Hyrje .....	7
Numri dhe natyra e vendimeve të OSHP-së në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023 .....	8
Kohëzgjatja në marrjen e vendimeve dhe pasojat në prokurim publik.....	9
Vendimet pro interesit publik.....	11
Mungesa e konsistencës në vendimarrje .....	12
Vendimet pa konstatim nga Paneli Shqyrtues .....	13
Vonesat në vendimarrje.....	16
Vendimet pjesërisht të bazuara dhe mos konfiskimi i tarifës së ankesës.....	18
Transparenca .....	19
Angazhimi i ekspertëve, gabimet dhe mostrajtimi i lëndëve në mënyrë adekuate .....	21
Përfundime .....	23
Rekomandime .....	24

# Përmbledhje ekzekutive

Ky raport monitorues, i punuar nga Demokraci Plus (D+) i nënkontraktuar nga aktiviteti i USAID-it për Integritet Komunal në Kosovë (KMI), paraqet një vlerësim të punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Vlerësimi është i bazuar në vëzhgimet e monitoruesve gjatë periudhës gjashtëmujore korrik - dhjetor 2023. Monitoruesit kanë vëzhguar vendimet dhe praktikët e OSHP-së për të vlerësuar paanshmërinë e këtij mekanizmi në trajtimin e ankesave të paraqitura nga palë të ndryshme. Raporti vë në pah progresin e arritur dhe sfidat e ndryshme të performancës së OSHP-së, në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023, si:

- vonesat në vendimarrje;
- gabimet e ekspertëve;
- mos konsistenca në vendimarrje;
- vendimet pa konstatim (rezultate përfundimtare);
- mungesa e transparencës.

Gjatë periudhës së monitorimit, OSHP-ja shpesh ka dështuar në respektimin e afatit ligjor në nxjerrjen e vendimeve për ankesa të paraqitura nga operatorët ekonomikë. Sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), afati ligjor për marrjen e vendimeve është 34 ditë, por që mund të zgjatet edhe 20 ditë shtesë, në raste të veçanta<sup>1</sup>. Një situatë tjetër e identifikuar në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023, është tendenca e OSHP-së për të nxjerrë vendime pa konkluzione të qarta. Kjo qasje formon mundësi për operatorët ankues që të kundërshtojnë vendimet e AK-së në gjykatat kompetente.

Gjatë periudhës së shqyrtimit, monitoruesit vunë re një rritje të konsiderueshme në aprovimin e pjesshëm të ankesave, praktikë e cila ishte eliminuar thuajse në tërësi në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023<sup>2</sup>. Miratimi i pjesshëm i mundëson OSHP-së që të kthejë plotësisht tarifat e ankesës tek operatorët ekonomikë edhe nëse vendimi ishte në favor të autoritetit kontraktues.

Duke pasur parasysh raportimet e mëparshme të shoqërisë civile, monitoruesit në këtë rast raportuan edhe për çështje të transparencës brenda OSHP-së. Raporti vë në pah përmirësim në çështjen e transparencës së këtij organi, por me çështje të cilat kanë nevojë për adresim, siç janë publikimi i raporteve të ndërmjetme në faqen e tyre të internetit, jo të gjitha seancat transmetohen online, mungesa e njoftimeve në faqen e internetit për orarin e mbajtjes së seancave, disa dokumente nuk ngarkohen në datat e sakta dhe vendimet shpërndahen në formate të skanuara që vështirë lexohen. Këto janë ndër gjetjet kryesore në këtë raport.

<sup>1</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Ligji për Prokurim Publik në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), neni 117, pika 1, (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

<sup>2</sup> Raporti i monitorimit të OSHP-së nga D+ (janar - qershor 2023), ([https://dplus.org/wp-content/uploads/2023/09/18-09-23\\_Organi-Shqyrtues-i-Prokurimit-Monitorim-dhe-rekomandime.pdf](https://dplus.org/wp-content/uploads/2023/09/18-09-23_Organi-Shqyrtues-i-Prokurimit-Monitorim-dhe-rekomandime.pdf))

# Hyrje

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është organ i pavarur administrativ i cili ka kompetenca për shqyrtimin e ankesave në prokurim publik nga furnizuesit, ofruesit e shërbimeve dhe/ose kontraktuesin e punëve (të njohur si operatorë ekonomikë). Pas pranimit të ankesës me shkrim lidhur me vendimin e marrë nga autoriteti kontraktues, OSHP-ja ka mandat të shqyrtojë ankesat brenda afateve të përcaktuara me ligj, për të siguruar zgjidhje në kohë. Pas përfundimit të shqyrtimit, OSHP nxjerrë një vendim me shkrim që adreson pretendimet ankimore të palës dhe merr vendim për aktivitetin e prokurimit ndaj të cilit është paraqitur ankesa.

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2023, ngjashëm me gjashtë mujin e parë, OSHP-ja ka funksionuar pa bord të kompletuar për shkak të shkarkimit të një anëtari në fillim të muajit korrik të vitit 2023 nga Kuvendi i Kosovës<sup>3</sup> me kërkesë të Qeverisë së Kosovës. Ky shkarkim, nën arsyetimin se kishte shkelur kodin e etikës profesionale në rastin e aktivitetit të prokurimit për furnizim me insulina ngjalli shumë polemika. Qeveria nuk kishte dhënë një arsyetim konkret për kërkesën për shkarkimin vetëm të një anëtari, edhe pse në panelin shqyrtues në të cilin ishte marrë vendimi për kthimin në rivlerësim të tenderit për insulina, kishin qenë edhe dy anëtarë të tjerë të bordit të OSHP-së. Për më tepër nuk ishte publikuar asnjë dokument ose vlerësim që dëshmonte se anëtarja e shkarkuar ka shkelur etikën profesionale. Ky vendim më pas përfundoi në Gjykatën Kushtetuese, për tu vlerësuar ligjshmëria dhe kushtetutetshmëria e tij. Kanë kaluar më shumë se 150 ditë pa vendim të këtij organi. Efikasiteti i bordit u rrezikua pasi tre anëtarët e mbetur duhej të menaxhonin ngarkesën e shtuar të punës e përforcuar më tej nga bartja e 173 ankesave të pazgjidhura nga gjashtë muajt e parë të vitit 2023, në gjysmën e dytë të vitit 2023. Gjithashtu, pati një rritje të dukshme të numrit të ankesave gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, të cilat arritën në total 623 sosh, duke shënuar një rritje prej 177 ankesash krahasuar me gjashtë muajt e parë.

Duke shtuar kompleksitetin, OSHP në fillim të muajit gusht 2023, vendosi të ndryshonte edhe Rregulloren nr.01/2020 të Punës së OSHP-së. Me 8 gusht 2023, OSHP-ja ka ndryshuar nenin 21<sup>4</sup>, të Rregullores në fjalë, konkretisht duke adresuar themelimin dhe përbërjen e paneleve shqyrtuese bazuar në vlerat e kontratës ndaj të cilave është ushtruar ankesë në OSHP. Është përcaktuar se ankesat lidhur me kontratat me vlerë deri në 300,000.00 euro duhet të shqyrtohen nga panele individuale. Megjithatë, këtij ndryshimi i mungonte transparenca, pasi nuk pati asnjë diskutim publik rreth tij.

Pavarësisht ndryshimit të lartpërmendur, vonesat në procesin e vendimmarrjes vazhduan.

Pak ditë pasi në Kuvend u votua emërimi i anëtarit të ri të bordit në tetor 2023, duke e rikthyer këtë organ në katër anëtar funksional, njëri nga anëtarët e zgjedhur vitin e kaluar dha dorëheqje në nëntor 2023 për arsye personale. Ky largim e la (shpiu) bordin me një përbërje jo të plotë.

<sup>3</sup> Vendimi për shkarkimin e anëtares së Bordit të OSHP-së ([https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023\\_07\\_18\\_\(13\\_07\\_2023\)Vendimershkarkimineznj.KimeteGashingapozitaeanetaresseOrganitShqyrtuesteProkurimit\\_6gwUfqvDpj.pdf](https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_07_18_(13_07_2023)Vendimershkarkimineznj.KimeteGashingapozitaeanetaresseOrganitShqyrtuesteProkurimit_6gwUfqvDpj.pdf)), (qasur për herë të fundit me 31 dhjetor 2023)

<sup>4</sup> Rregullorja e ndryshuar nr. 01.2020 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?Id=32d256d8-2a52-ee11-b5bc-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit me 31 dhjetor 2023)

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023 OSHP ka funksionuar pa bord të kompletuar

623

ankesa brenda gjashtë muajve

Ndryshimi i Rregullores së Punës së OSHP-së u shoqërua me mungesë transparence

# Numri dhe natyra e vendimeve të OSHP-së në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023

Gjatë periudhës 2023, OSHP-ja ka nxjerrë

D+ ka monitoruar nxjerrjen e vendimeve nga OSHP nga 1 korriku deri në 31 dhjetor 2023. Gjatë kësaj periudhe, OSHP-ja ka nxjerrë 579 vendime, ndërsa në proces kanë mbetur 216 sosh. Gjatë kësaj periudhe, janë mbajtur gjithsej 38 seanca me palët e përfshira.

579  
vendime

216  
kanë mbetur  
në proces

OSHP-ja ka mbajtur  
38  
seanca me palët  
e përfshira.

Kategorizimi i vendimeve të marra gjatë kësaj periudhe raportuese është si më poshtë:



289

vendime kanë qenë në favor të OE që kanë parashtruar ankesa.



290

vendime ishin kundër OE ankues.



Në 85

raste, vendimet e OSHP-së nuk ishin në përputhje me rekomandimet e ekspertëve.

Për ankesat e pranuar, shpërndarja është si më poshtë:



81

ankesa kishin të bëjnë me njoftimin për kontratë.



115

ankesa kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.



376

ankesa kishin të bënin me njoftimet për dhënie të kontratës.



Gjithashtu

7

ankesa të tjera.



# Kohëzgjatja në marrjen e vendimeve dhe pasojat në prokurim publik

Vonesat e shkaktuara nga ankesat mund të rezultojnë në shtyerje të konsiderueshme të investimeve kapitale, duke ndikuar në projekte me vlerë të konsiderueshme për muaj të tërë. Tenderët që kanë ndikim sezonal, si mirëmbajtja e rrugëve verore dhe dimërore, janë veçanërisht në rrezik për ndikim negativ tek qytetarët. Pezullimi i këtyre aktiviteteve të prokurimit mund të ketë efekte negative në shërbimet publike dhe infrastrukturën, duke theksuar më tej urgjencën e adresimit dhe zgjidhjes së ankesave në kohë dhe me efikasitet.

Për shembull, OSHP është vonuar 172 ditë në marrjen e vendimit lidhur me tenderin për “Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, Prishtinë - Besi - Podujevë, Lloti 0, 1, 2, 3 dhe strukturat Llot 5”, aktivitet ky i inicuar nga MMPHI. Lënda në OSHP ishte dorëzuar me datën 15 qershor 2023, derisa vendimi nga paneli shqyrtues ishte marrë me 4 dhjetor 2023. Në fakt, fillimisht për këtë lëndë tre ekspertë kishin refuzuar ta pranojnë mandatin për shqyrtimin paraprak të saj. Po ashtu, gjatë procesit ishte zëvendësuar edhe kryesuesi i panelit shqyrtues, pasi ai paraprak kishte dhënë dorëheqje. Gjithashtu, paneli kërkoi interpretim nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik gjatë shqyrtimit të këtij rasti. Këta faktorë kontribuan në zgjatjen e afatit për të marrë një vendim në këtë rast.

Ngjashëm, ishte vonesa prej 133 ditëve edhe për aktivitetin e prokurimit ‘Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe paisjeve rrugore ne komunën e Gjilanit’ e inicuar nga komuna e Gjilanit, me vlerë të parashikuar 340,000.00 euro. Ankesa në OSHP u deponua me 7 gusht 2023, derisa vendimi nga paneli shqyrtues ishte marrë me 18 dhjetor 2023. Pretetendimet e palës ankuese kishin të bëjnë me faktin se komuna ka bërë vlerësim të gabuar të dokumentacionit të tyre tenderues dhe referencave për punë të ngjashme. Gjithashtu, edhe për këtë lëndë, paneli shqyrtues gjatë shqyrtimit të procesit u ndryshua, pasi njëri nga anëtarët dha dorëheqje nga pozita e anëtarit të bordit të OSHP-së, derisa angazhimi i anëtarit tjetër deri tek marrja e vendimit për këtë lëndë mori kohë, pasi i duhej ta analizonite rastin nga fillimi për të marrë një vendim të bazuar në merita.

Në një rast tjetër, mbi 100 ditë iu deshën panelit shqyrtues të marrë një vendim edhe për aktivitetin e prokurimit ‘Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve fekale dhe atmosferike’ i inicuar nga Komuna e Podujevës me vlerë të parashikuar 3,061,853.52 euro. Ankesa në OSHP u dorëzua me 31 korrik 2023, derisa vendimi nga paneli shqyrtues ishte marrë me 21 nëntor 2023.

Këto vonesa në marrjen e vendimeve, të shkaktuara edhe nga rrethanat e krijuara gjatë kësaj periudhe në OSHP, përfshirë dorëheqjen ose shkarkimin e anëtarëve, shpie në dëme materiale për operatorët ekonomik të përfshirë, dhe kanë ndikuar në mirëqenien e qytetarëve. Vonesat e tilla mund të prishin operacionet dhe investimet e planifikuara të bizneseve, duke ndikuar si në operatorët ekonomikë ashtu edhe në ata publik. Zgjidhja e menjëhershme e ankesave është thelbësore për ekzekutimin pa probleme të projektit dhe për të shmangur pengesat financiare dhe ndërprerjet për të gjitha palët e interesuara.

Gjatë periudhës monitoruese, OSHP kishte pranuar ankesë nga operatori ekonomik ‘Profesional Alarm LLC, ndaj autoritetit kontraktues, Komuna e Prishtinës për aktivitetin e prokurimit ‘Vendosja e kamerave ne Kryeqytet’. Vlera e parashikuar e projektit ishte 1,350,000.00 euro. Megjithatë, kjo ankesë duhej

Gjatë periudhës së monitorimit, OSHP shqyrtoi një ankesë e cila është dashur të refuzohet si e papranueshme

të ishte hedhur poshtë si e papranueshme në momentin e pranimit. Ankesa e operatorit ishte në kundërshtim me nenin 108/A<sup>5</sup> të LPP-së, pasi që kërkesa e tij për rishqyrtim është hedhur poshtë si e palejuar fillimisht nga autoriteti kontraktues, pasi ankesën e kishte dorëzuar jashtë afatit të paraparë me ligj.

Rrjedhimisht, OSHP-ja nuk është dashur ta procedojë ankesën, që do të thotë se nuk është dashur të caktohet asnjë ekspert shqyrtues dhe ankesa është dashur të hudhet përfundimisht si e papranueshme.

OSHP-ja është vënë në dijeni për lëshimin administrativ vetëm pas marrjes së përgjigjes në ankesë nga AK-ja, Komuna e Prishtinës. Kjo mbikëqyrje i ka dhënë AK-së të drejtën, siç është pranuar në vendimin e publikuar.<sup>6</sup>

Lëshimet e tilla administrative nga ana e OSHP, krijojnë shpenzime të panevojshme për këtë organ, rrjedhimisht ndikojnë negativisht në besimin e publikut. Për më tepër AK-ja përballet me pasoja të konsiderueshme për shkak të mungesës së kontratës.

---

<sup>5</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Neni 108/A, pika 3 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/-068 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

<sup>6</sup> Numri i vendimit 732/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/0ba6badf-e082-ee11-b5ba-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

# Vendimet pro interesit publik

Sipas nenit 132, pika 1.2 e Ligjit për Prokurimin Publik, parashihet që një kontratë mund të shfuqizohet pjesërisht ose plotësisht nga OSHP, në rast se konstatohet se ajo ishte nënshkruar para përfundimit të afatit të pritjes prej 10 ditësh<sup>7</sup>, prej momentit të njoftimit për dhënie të kontratës deri në momentin e nënshkrimit të kontratës.

OSHP, në një rast kishte evidentuar një shkelje të tillë, por që duke e bazuar vendimin në interesin publik, nuk kishte pezulluar apo shkëputur kontratën.

Për aktivitetin e prokurimit 'Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, Prishtinë - Besi - Podujevë, Lloti 0, 1, 2, 3 dhe strukturat Llot 5' i inicuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), me vlerë të parashikuar 37,599,981.94 euro, kompania Sallahu Sh.P.K. që kishte marrë pjesë në këtë tender, kishte dorëzuar ankesë në OSHP më 16 qershor 2023, duke numëruar disa shkelje, në mesin e tyre edhe mosrespektimi i afatit të pritjes për nënshkrim të kontratës. OSHP, 172 ditë më pas, me vendimin 397/23<sup>8</sup>, kishte vërtetuar se AK kishte vepruar në kundërshtim me LPP-në, pasi nuk kishte pezulluar aktivitetin e prokurimit pas ankesës në OSHP dhe kishte nënshkruar kontratën duke mos e respektuar përfundimin e afatit të pritjes pas njoftimit për dhënie të kontratës. Prandaj, për këtë shkelje OSHP kishte kërkuar revokim të licencës për zyrtarin përgjegjës të prokurimit në AK, por nuk kishte pezulluar apo shkëputur kontratën.

Paneli, vendimin e AK-së i cili ishte në kundërshtim me LPP e kishte lënë në fuqi, përkundër kundërshtimit të tij me Ligjin e Prokurimit Publik, duke u mbështetur kryesisht në parimin e përgjithshëm të interesit publik. Vendimi ishte bazuar në nenin 104, pika 4<sup>9</sup> të të LPP-së, sipas të cilit OSHP duhet të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik. LPP, neni 132, pika 2,4<sup>10</sup>, parasheh edhe kompensim të dëmit ndaj OE ankues, në rast se vërtetohen shkeljet e AK-së. Por, për rastin në fjalë ky urdhër nuk ishte lëshuar për shkak se OSHP kishte vërtetuar se OE ankues ishte i papërgjegjshëm, pasi nuk kishte plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

---

7 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Neni 132, pika 1.2 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/-068 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

8 Vendimi numër 397/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/45dec33f-6d93-ee11-b5be-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

9 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Neni 104, pika 4 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

10 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Neni 132, pika 2.4 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

# Mungesa e konsistencës në vendimmarrje

Në mënyrë që të sigurohet konsistenca në vendimmarrje, OSHP ende nuk ka zhvilluar ndonjë metodologji të detajuar që mundëson vendime uniforme dhe trajtim të njëjtë të ankesave. Gjatë ngjarjes së lansimit për përdorim të brendshëm të platformës Sistemi për Menaxhimin e Lëndëve (SML), OSHP kishte njoftuar se ky sistem do të ndihmoj bordin e OSHP-së të siguroj konsistencë në vendimmarrje dhe trajtim të njëjtë të ankesave. SML, i cili është zhvilluar për përdorim të brendshme, synonte të rriste konsistencën e vendimmarrjes duke mundësuar marrjen e ankesave në një format të lexueshëm dhe duke i lejuar bordit të ketë qasje në të gjitha ankesat dhe vendimet rast pas rasti<sup>11</sup>. Mirëpo, edhe pse gjatë kësaj periudhe monitoruese pati progres në konsistencën e vendimeve, dhe që OSHP tani përdor një bazë të dhënash të brendshme për këtë qëllim, D+ vërejtur se ka ende hapësirë për përmirësim në këtë drejtim. Specifikisht, në një rast është vërejtur se ka mungesë së konsistencës.

Kur një ankesë e operatorit ekonomik cilësohet e pabazuar, tarifa e ankesës zakonisht konfiskohet. Megjithatë, në një rast specifik, OSHP nuk kishte konfiskuar tarifën e ankesës ndaj operatorit ankues edhe pse ankesën e tij e kishte refuzuar. Për aktivitetin e prokurimit 'Avancimi i platformës së prokurimit elektronik - ndërlihdja me sistemin e Thesarit' i iniciuar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), me vlerë të parashikuar 75,000.00 euro, operatori ekonomik 'Cactus Sh.A' kishte dorëzuar ankesë në OSHP kundër vendimit për dhënie të kontratës. Eksperti shqyrtues i lëndës, i kishte dhënë të drejtë OE ankues, duke rekomanduar që të bëhet anulimi i vendimit për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

**Në një rast specifik, OSHP nuk kishte konfiskuar tarifën e ankesës ndaj operatorit ankues edhe pse ankesën e tij e kishte refuzuar.**

Por, paneli shqyrtues kishte konsideruar se veprimet e AK-së dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për ri-vlerësim të aktivitetit të prokurimit. OSHP në këtë rast ankesën e kishte refuzuar, duke e lënë në fuqi vendimin e AK-së, por kishte lejuar kthimin e tarifës së ankesës<sup>12</sup>. Tarifa e depozitimit të ankesës i është rimbursuar operatorit ankues në momentin që ankesa konsiderohej e justifikuar ose nëse operatori e tërhoqi ankesën. Ligji i Prokurimit Publik nuk parashikon rimbursim të tarifës nëse ankesa tërhiqet. Në vend të kësaj, është Rregullorja e Punës e OSHP-së që specifikon rastet në të cilat tarifa rimbursohet pas tërheqjes së ankesës.

OSHP-ja e kishte arsyetuar vendimin duke iu kishte referuar Rregullores së punës së OSHP-së, nenit 31, pika 6<sup>13</sup>. Sipas kësaj rregulloreje, në rast se ankesa cilësohet e bazuar ose OE tërhiqet nga ankesa, atëherë ankuesi mund të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës e cila është bërë në momentin e parashtrimit të ankesës.

11 Organi Shqyrtues i Prokurimit, Komunikatë për media, 31.01.2023 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Pages/Details?id=351>)

12 Vendimi i OSHP-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/2776fda8-777d-ee11-b5bd-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit me 31 dhjetor 2023)

13 Rregullorja e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 31, pika 6 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=0d49ce49-afc2-eb11-b59b-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit me 31 dhjetor 2023)

# Vendimet pa konstatim nga Paneli Shqyrtues

Funksioni primar i OSHP-së si organ mbikqyrës është të vlerësoj ligjshmërinë e vendimeve të marra nga autoritetet kontraktuese, dhe të jap përgjigje në pretendimet ankimore. Mirëpo, gjatë kësaj periudhe, D+ ka vërejtur në disa raste se OSHP ka marrë vendim pa arritur në një përfundim të caktuar. Në disa raste, OSHP-ja ka përfunduar procedurat duke mos konstatuar as në favor të autoritetit kontraktues as të operatorit ekonomik. Përkundër mungesës së një vendimi përfundimtar, OSHP-ja rekomandoi që operatorët ankues të ndjekin rastin në gjykatë.

Në tri raste, vendimet e Panelit Shqyrtues kanë qenë pa konkluzion të qartë

Rast shembull: Komuna Skënderaj v. GOE Everlight SHPK, NNSH RISI-COM, ITE Engeenering SHPK Dega në Kosovë

Me 29.09.2023, Komuna Skënderaj në cilësinë e autoritetit kontraktues kishte publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime të Energjisë sipas udhëzimit administrativ me nr.06/2021 per shërbimet e energjisë (esco)”. Autoriteti kontraktues kishte zbatuar procedurë të hapur për këtë shërbim të kontratës, me vlerë të parashikuar: 2,500,000.00 € . Hapja e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit ishte bërë me datë 19.10.2022. Pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit kishte qenë vetëm një OE, i cili kishte ofertuar si grup i operatorëve ekonomik. Më pas, më datë 06.12.2022, publikon njoftimin mbi vendimin e AK-së, duke e shpallur fitues GOE Everlight SHPK, NNSH RISI-COM, ITE Engeenering SHPK Dega në Kosovë.

Pas kalimit të afatit ligjor për parashtrim të kërkesave për ri-shqyrtim, dhe pa ndonjë kërkesë të tillë të pranuar, konform afateve ligjore të përcaktuara në LPP gjegjësisht nenit 108/A<sup>14</sup>, autoriteti kontraktues më datë 13.12.2022, publikoi njoftimin për dhënie të kontratës. Pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, AK nuk ndërmerr asnjë veprim për 7 muaj. Me datë 17.07.2023 u publikua njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit duke përmendur mungesën e fondeve buxhetore. Arsyeja e anulimit me arsyetimin ”për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore” ishte e bazuar në nenin 9 të LPP, paragrafi 3<sup>15</sup>, nenit 8 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik dhe udhëzuesit 001/2023 ku mungon konfirmimi për zotim të mjeteve.

I pakënaqur me këtë vendimin të AK-së, OE “Everlight”, ankuesi i shpallur më herët si i fitues i kësaj kontrate, me datën 04.08.2023 kishte parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 547/23<sup>16</sup>. Eksperti shqyrtues i kësaj lënde, kishte rekomanduar anulimin e vendimit të AK-së për anulim të aktivitetit dhe të vazhdohej me procedurat e aktivitetit të prokurimit.

<sup>14</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 108/A (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

<sup>15</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 9 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

<sup>16</sup> Ankesa në OSHP (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/f408b397-c532-ee11-b5ba-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

Ndërsa, paneli shqyrtues nuk kishte marrë vendim as në mbështetje të vendimit të AK-së, për anulim të aktivitetit, por as kundrejt ankesës së operatorit ekonomik 'EVERLIGHT Sh.P.K'. Në këtë rast unik, paneli shqyrtues nxorri vendim pa konstatim të prerë, duke i sygjerruar OE ankues që ti drejtohet gjykatës kompetente, praktikë kjo jo e hasur deri tani. OSHP-ja e arsyetoi këtë qasje duke pohuar se me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës nga AK-ja, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur. OSHP-ja argumentoi se koha për paraqitjen e ankesave si në AK ashtu edhe në OSHP kishte skaduar, dhe veprimet e AK-së kishin ndodhur pas mbylljes së aktivitetit të prokurimit.

Paneli Shqyrtues në vendimin e saj kishte numëruar shkeljet të cilat kishte bërë AK në këtë aktivitet të prokurimit. OSHP-ja kishte evidentuar se AK me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit kishte bërë shkelje të dispozitave ligjore për prokurim publik. Pasi që neni 62 i LPP<sup>17</sup> e saktëson se në cilat raste mund të përfundoj aktiviteti i prokurimit, po ashtu edhe në nenin 43 të Rregullores së KRPP-së<sup>18</sup> përcaktohen rastet se kur mund të bëhet ndërprerja e procedurës së prokurimit, OSHP-ja nuk e ka gjetur të arsyeshme, justifikimin e AK-së për ndërprerjen e kësaj procedure në asnjërën nga këto dispozita. Paneli Shqyrtues kishte identifikuar dispozitat ligjore për prokurimin publik që janë relevante për këto veprime të AK-së. Kjo sepse AK është i obliguar që konform dispozitave ligjore ta bëjë ligjshmërinë e secilit veprim dhe këto të verifikohen para inicimit të aktivitetit të prokurimit por edhe në fazat e më të vonshme, ndërsa, jo në fazën kur publikohet njoftimi për dhënie të kontratës, kur pritet të bëhet edhe nënshkrimi i kontratës nga palët. Sepse me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës nga ana e AK, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur sepse kalon edhe koha për ankesë në AK dhe OSHP, dhe këto veprime të AK janë pas mbylljes së aktivitetit të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, kishte vlerësuar se funksioni i saj karshi kësaj lënde, përfundon me rastin e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës dhe skadimit të afateve kohore për ankesë në AK dhe OSHP. OSHP vendimin e kishte bazuar në nenin 10 të LPP-së, i cili nuk parasheh se kur përfundon funksioni i OSHP-së në trajtimin e një anese, por flet për transparencën në procesin e prokurimit publik. Pika 3 e këtij neni<sup>19</sup>, mbi të cilën edhe e ka bazuar vendimin e saj OSHP, specifikon se në cilat raste palët e interesit nuk mund të bëjë kërkesë për qasje në dokumentet e një aktiviteti të prokurimit, pra nuk flet mbi periudhën se kur përfundon funksioni i OSHP-së karshi trajtimit të një anese nga ana e këtij organi.

### **Ministria e Shëndetësisë vs. "Infosoft Systems"**

Në aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e 70% të HW të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) për Institucionet Shëndetësore " i inicuar nga AK Ministria e Shëndetësisë, në vlerë të parashikuar 720,000.00 euro, Paneli Shqyrtues kishte përdorur qasje të ngjashme sikurse është vërejtur në rastin e Komunës së Skenderajt.

Ankesa e OE "Infosoft Systems" kundër vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë për anulimin e aktivitetit të prokurimit është vlerësuar e pabazuar nga eksperti shqyrtues. Ndryshe nga rasti i AK-së, Komuna e Skenderajt, eksperti shqyrtues propozoi vërtetimin e vendimit të AK-së dhe hudhjen e ankesës si të pabazuar. Paneli në këtë rast nuk kishte marrë për bazë mendimin e ekspertit dhe në vendimin e saj i kishte sygjerruar OE-së të i drejtohej gjykatës, por duke mos i dhënë të drejtë AK-së për vendimin e marrë.

17 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 62 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

18 Rregullorja e Punës së Komisionit Rregulltaiv të Prokurimit Publik, neni 43 (<https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20e%20Pun%C3%ABs%20e%20Komisionit%20Rregullativ%20t%C3%AB%20Prokurimit%20Publik.pdf>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

19 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 10, pika 3 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

## Ministria e Shëndetësisë vs. “Flamur Isufi” B.I.

Në një skenar paralel, Paneli Shqyrtues kishte nxjerrur përfundim të njëjtë në shqyrtim administrativ, edhe për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHPK) Llot 2” i inicuar nga AK Ministria e Shëndetësisë (MSh), me vlerë të parashikuar 359,600.00 euro. MSh kishte nxjerr njoftim për anulim të nënshkrimit për kontratë, nën arsyetimin se ka dyshime për kufizim të konkurrencës. Eksperti shqyrtues ankesën e operatorit ekonomik “Flamur Isufi” B.I. të parashituar në OSHP e kishte cilësuar të bazuar dhe kishte kërkuar rikthim të aktivitetit në rivlerësim. Megjithatë, Paneli Shqyrtues, ngjashëm me rastet paraprake, nuk kishte marrë për bazë mendimin e ekspertit. Në vendimin e tij, paneli kishte sugjeruar OE-së të i drejtohej gjykatës, pa e pranuar vendimin e AK-së.

Është e rëndësishme të theksohet se OSHP-ja ka mandat dhe ka për obligim ligjor<sup>20</sup> që të trajtoj pretendimet ankimore të palës ankuese dhe në bazë të saj të marrë një vendim për atë lëndë, brenda afateve ligjore. Andaj, përfundimi i procedurave pa një vendim të OSHP-së nënkupton mos përmbushje të detyrave dhe mos përmbushje të funksionit kryesor të OSHP-së.

---

<sup>20</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 98,99(<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

# Vonesat në vendimarrje

Sipas LPP-së<sup>21</sup> pas pranimit të ankesës nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar ta publikojë vendimin në uebfaqe brenda 34 ditëve. Eksperti shqyrtues ka 10 ditë kohë për të shqyrtuar ankesën<sup>22</sup>, përderisa autoriteti kontraktues dhe operatori ekonomik kanë katër ditë kohë për të dhënë përgjigje në ekspertizë<sup>23</sup>. Më pas, OSHP ka 15 ditë kohë për të marrë vendim, dhe brenda pesë ditëve vijuese duhet ta publikojë vendimin<sup>24</sup>, që gjithsej janë 34 ditë. Në raste të caktuara kur OSHP konsideron se një rast është kompleks, e ka autoritetin të shtyjë afatin për nxjerrjen e vendimit për 20 ditë më së shumti. Në këto raste, OSHP-ja duhet të ofrojë një arsytim dhe deklaratë për të arsyetuar zgjatjen.

Gjatë periudhës monitoruese, OSHP ka nxjerrur gjithsej 406 vendime mbi ankesat e parashtruara në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023. Përveç kësaj, OSHP ka trajtuar 173 lëndë të bartura nga gjashtë mujori i parë i vitit 2023, duke i llogaritur në total kështu 579 vendime të publikuara nga 1 korriku deri më 31 dhjetor 2023. Sfida e tejkallimit të afatit ligjor për trajtimin e lëndëve vazhdoi edhe gjatë kësaj periudhe raportuese. Nga 579 vendimet e publikuara, vetëm 147 ankesa u adresuan brenda afatit ligjor të përcaktuar me ligj, prej 34 ditëve. Vlen të theksohet se më shumë se gjysma e këtyre vendimeve ishin ankesa të pasafatshme apo të palejuara, ankesa këto që nuk futen fare në shqyrtim të panelit.

Ashtu siç e rregullon edhe LPP, jashtë periudhës prej 34 ditësh, OSHP e ka autoritetin të shtyjë afatin për nxjerrjen e vendimit për 20 ditë më së shumti, pra në total 54 ditë<sup>25</sup>. Megjithatë, këto zgjatime duhet të shoqërohen me një arsytim dhe deklaratë që arsyeton nevojën e zgjatjes.

579

vendime të publikuara nga  
1 korriku deri më 31 dhjetor  
2023

147

Vetëm  
ankesa u adresuan brenda  
afatit ligjor të përcaktuar  
me ligj

21 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 115, 116 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), [qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023]

22 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), neni 114, pika 1, [qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023]

23 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), neni 115, pika 1, [qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023]

24 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), neni 117, pika 1, [qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023]

25 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), neni 117, pika 1, [qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023]



## Gjatë periudhës monitoruese D+<sup>26</sup> ka gjetur se në:



147

raste OSHP ka nxjerrë vendim brenda afatit prej 34 ditësh.



142

raste OSHP ka nxjerr vendim brenda afatit shtesë, 54 ditë.



290

raste është tejkeluar periudha prej 54 ditësh.



57

raste OSHP-së i janë dashur mbi 100 ditë për nxjerrjen e vendimeve.

## Gjatë monitorimit D+27 ka gjetur ankesat me afatin me të gjatë të vendimmarrjes:

Zgjerimi i rrugës Nationale N25, Prishtinë - Besi - Podujevë, Lloti 0, 1, 2, 3 dhe strukturat Llot 5, 172 ditë deri në publikimin e vendimit.

Ndërtimi Shkolla Fillore e Mesme e Ulët (SHFMU) në Pozharan - Komuna e Vitisë - vazhdimi i punimeve, 166 ditë deri në publikimin e vendimit.

Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish, 138 ditë deri në publikimin e vendimit.

26 Të dhënat janë nxjerrë nga uebfaqja e OSHP-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/default/index>)

27 Të dhënat janë nxjerrë nga uebfaqja e OSHP-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/default/index>)

# Vendimet pjesërisht të bazuara dhe mos konfiskimi i tarifës së ankesës

Çdo operatorë ekonomike që dëshiron ta kontestojë vendimin e autoritetit kontraktues, duhet të paguajë një tarifë për tu ankuar që mund të kushtojë nga 100 deri në 5000 euro<sup>28</sup>. Sipas Rregullores së Punës së OSHP-së, kur pretendimet ankimore në një ankesë janë të pabazuara, OSHP duhet ta konfiskojë tarifën e ankesës<sup>29</sup>.

Gjatë periudhës së monitorimit nga D+, tarifa e ankesës ndaj operatorëve ekonomike (OE) është konfiskuar në 117 raste, me shumë totale prej 149,940,66 euro. Kjo shumë është 60,007.67 euro më pak sesa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023<sup>30</sup>, ku tarifa ishte konfiskuar në 97 raste.

Sipas Rregullores së Punës së OSHP-së, tarifa e ankesës nuk konfiskohet në rast se ankesa është e bazuar, para shqyrtimit të saj ose emërimit të ekspertit dhe para pranimit të ekspertizës ose e njehta cilësohet e pa lejuar nga ana e OSHP-së. Për dallim nga gjashtë mujori i parë i vitit 2023, OSHP në gjashtë mujorin e dytë ka rikthyer praktikën e aprovimit të pjesshëm të ankesave, duke e lënë në fuqi vendimin e AK-së, duke siguruar kështu që tarifa të mos konfiskohet. Vlen të theksohet se miratimi i pjesshëm nuk është specifikuar në asnjë rast në Ligjin e Prokurimit Publik.

Për aktivitetin e prokurimit 'Furnizim me Inventar (mobile) dhe kasaforta të sigurisë për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) e ndarë në dy pjesë: 1. Furnizim me Inventar për zyrë dhe 2. Furnizim me kasaforta Sigurie' i iniciuar nga AK Ministria e Mbrojtjes, me vlerë të parashikuar 150,000.00 euro, paneli shqyrtues kishte adresuar njërin nga pretendimet e operatorit ankues "Graniti" Sh.P.K. Në kërkesë thuhej se AK nuk kishte ofruar fakte dhe prova në përgjigjen për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Paneli shqyrtues këtë pretendim e kishte cilësuar si pjesërisht të bazuar, por që nuk ndikoi që aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

tarifa e ankesës ndaj operatorëve ekonomike (OE) është konfiskuar në

**117**

raste, me shumë totale prej **149,940,66 euro.**

28 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), neni 118, pika 4, (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

29 Rregullorja e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=0d49ce49-afc2-eb11->), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

30 Raporti monitorimit të OSHP-së nga D+ (janar - qershor 2023), ([https://dplus.org/wp-content/uploads/2023/09/18-09-23\\_Organi-Shqyrtues-i-Prokurimit-Monitorim-dhe-rekomandime.pdf](https://dplus.org/wp-content/uploads/2023/09/18-09-23_Organi-Shqyrtues-i-Prokurimit-Monitorim-dhe-rekomandime.pdf))

# Transparenca

OSHP edhe gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2023 vazhdoi të shënoj progres në ngritjen e transparencës së punës së saj. Megjithatë mbeten disa çështje të cilat duan adresim në të ardhmen. Faqja zyrtare e internetit e OSHP-së, vazhdon të përmendet edhe sot si mjet i vlefshëm që ka rritur në masë të madhe transparencën brenda këtij institucioni; por e njëjta vazhdon të ketë probleme. Në uebfaqe vazhdon praktika e ngarkimit të dokumenteve në formatin e skenuar, që e pamundëson kërkimin në tekst dhe që dokumenti të lexohet nga kompjuteri.



OSHP edhe gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2023 vazhdoi të shënoj progres në ngritjen e transparencës së punës së saj.



Uebfaqja e OSHP-së vazhdon të ketë mangësi.



Kërkesat e AK-së për përfshirje në listën skualifikuese të OE nuk janë të publikuara në uebfaqe.

Gjatë periudhës korrik-dhjetor 2023, OSHP-ja kishte publikuar vendimet në faqen e internetit për operatorët që janë futur në listën diskualifikuese në përgjigje të kërkesave nga autoritetet kontraktuese. OSHP-ja i ka shtuar katër operatorë ekonomikë në këtë listë. Megjithatë, në vendimin 413/23<sup>31</sup> në dokumentin e publikuar në uebfaqe mungon faqja dy e vendimit ku gjendet arsyetimi i plotë i vendimit të këtij organi që ta diskualifikoj operatorin ekonomik nga aktivitetet e prokurimit për periudhën 3 mujore. Ky organ, vazhdon të mos i publikoj në uebfaqe, në kohë reale, kërkesat e autoriteteve kontraktuese që propozojnë që një operator ekonomik, të futet në listën diskualifikuese. Një pjesë e kërkesës bëhet publike vetëm në rastin kur OSHP merr një vendim lidhur me atë kërkesë. Publikimi i kërkesave të AK-ve për futje në listë diskualifikuese të OE-ve nën pretendimin se kanë shkelur LPP-në, do ndikonte në ngritjen e transparencës në OSHP. Në një rast, publikimi i një vendimi nga OSHP ka shkaktuar paqartësi të palët e interesit. Për lëndët 920 dhe 934/23, ankesën e operatorëve ekonomik 'NTSH Sharr Travel' dhe 'Autotransporti Sh.a' e kishte refuzuar, por sipas vendimit të publikuar nga OSHP, aty përmendet se ankesa është e bazuar. Një lëshim i tillë teknik, krijon hapësirë për interpretime të ndryshme.

OSHP-ja duhet të tregojë kujdes gjatë publikimit të vendimeve për të shmangur keqkuptimet, mundësisht duke publikuar një konkluzion që sqaron çdo gabim.

31 Vendimi numër 413/22 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=0365e57b-7888-ee11-b5be-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit me 31 dhjetor 2023)

Për më tepër, faqja e internetit përballet me probleme që lidhen me publikimin e gabuar të datave. Shumë ankesa, vendime dhe ekspertiza kanë pasaktësi me datën e publikimit të shënuar në sistem. Në disa raste, data e publikimit të vendimit nga paneli, paraqitet e njëjtë me datën e paraqitjes së ankesës nga operatorët ekonomikë, duke shkaktuar kështu konfuzion. Ky problem është evident në lëndën me numër 437/23<sup>32</sup> ku shihet se data e ankesës paraqitet e njëjtë me datën e vendimit nga paneli shqyrtues. Shembull tjetër është rasti me numër 476/23<sup>33</sup>, ku ekspertiza nuk është publikuar deri pas vendimit nga ana e panelit shqyrtues. Ndryshe nga më parë, datat e sakta të ankesës dhe vendimit nuk janë lehtë të qasshme por kërkojnë hulumtim brenda dokumenteve që janë të ngarkuara. D+<sup>34</sup> gjatë monitorimit ka hasur në dhjetëra raste kur datat janë të publikuara gabimisht në sistem (p.sh rastet 476, 490, 491, 516, 548, 582, 605, 612, 685, 695, 764, 983, 984/23).

Një çështje tjetër që lidhet me transparencën ka të bëjë me transmetimin e seancave dëgjimore drejtëpërdrejt përmes platformës Youtube, e cila vazhdon të mbetet problem. Edhe pse gjatë mbajtjes së seancës mbahet edhe procesverbal me shkrim, operatori ekonomik ankues ka mundësi që seancën pas mbarimit ta sheh edhe përmes platformës Youtube, Mirëpo për të marrë lidhjen e transmetimit, paraprakisht duhet ta paraqes një kërkesë me shkrim në OSHP.

Një aspekt tjetër thelbësor rreth transparencës është siguri i qasjes së publikut në seancat dëgjimore nëpërmjet transmetimeve të drejtëpërdrejta. Fatkeqësisht, orari i mbajtjes së seancave dëgjimore nuk përditësohet në uebfaqen e OSHP-së. Kjo e fundit vazhdon ta arsyestoj këtë praktikë duke shprehur shqetësime rreth keqpërdorimeve potenciale nga palët e treta. Si rezultat, metoda e vetme për të pasur qasje në transmetime është duke parashtruar kërkesë zyrtare OSHP-së, e cila me pas e përcjellë linkun e transmetimit. Vonesat në përgjigje ndaj këtyre kërkesave mund të kenë pasoja negative për palët e interesit dhe do ndikoj direkt në transparencën e këtij organi.

Gjatë periudhës së raportimitka pasur raste kur seancat dëgjimore nuk janë transmetuar fare për shkak të problemeve teknike, siç është raportuar nga OSHP-ja. Rastet e evidentuara kur seanca nuk është transmetuar drejtëpërdrejt janë lëndët 543/23<sup>35</sup> dhe 267/23<sup>36</sup>.

---

32 Lënda në OSHP me numër 437/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?>), (qasur për herë të fundit me 31 dhjetor 2023)

33 Lënda në OSHP me numër 476/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?>) (qasur për herë të fundit me 31 dhjetor 2023)

34 Të dhënat janë nxjerrë nga uebfaqja e OSHP-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/default/index>)

35 Numri i lëndës: 543/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/6e0726c1-2a73-ee11-b5bd-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit me 31 dhjetor 2023)

36 Numri i lëndës: 267/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/34bec04e-3530-ee11-b5ba-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit me 31 dhjetor 2023)

# Angazhimi i ekspertëve, gabimet dhe mostrajtimi i lëndëve në mënyrë adekuate

Nëse OSHP-ja konstaton se ankesa është parashtruar me kohë nga operatori ekonomik dhe i plotëson kushtet sipas paragrafit 1 të Nenit 111<sup>37</sup> të LPP-së, do të vazhdojë menjëherë me emërimin e një eksperti për shqyrtim sipas nenit 113<sup>38</sup> të ligjit në fjalë.

Sipas nenit 114 të LPP-së<sup>39</sup>, brenda dhjetë (10) ditësh nga emërimi, eksperti shqyrtues do të shqyrtojë dokumentacionin e prokurimit të autoritetit kontraktues dhe shënimet përkatëse. Nëse konsiderohet e nevojshme ose e përshtatshme, eksperti mund të kryejë intervista me zyrtarë, punonjës ose këshilltarë si nga AK-të ashtu edhe nga pala që ka bërë ankesën. Pas kësaj, eksperti shqyrtues do t'i ofrojë panelit shqyrtues të OSHP-së, ankuesit dhe kryesuesit të AK-së një vlerësim gjithëpërfshirës me shkrim të aktivitetit të prokurimit në fjalë.

Eksperti shqyrtues luan një rol të rëndësishëm në proces duke rekomanduar veprime korigjuuese të nevojshme që duhet të ndërmerren nga autoriteti kontraktues. Këto veprime mund të përfshijnë: anulimin e aktivitetit të prokurimit, dhënies së kontratës ose rezultati i një konkursi të projektimit, zgjatjen e afatit kohor, ndryshimin ose anulimin e një vendimi të autoritetit kontraktues ose marrjen e çfarëdo masave të tjera të nevojshme për të korrigjuar shkeljet e bëra nga autoriteti kontraktues<sup>40</sup>. Gjatë kësaj periudhe është vërejtur se ekspertizat e ekspertëve shqyrtues janë dhënë me kohë.

Caktimi i ekspertëve shqyrtues në OSHP, më parë bëhej në mënyrë manuale, por me integrimin së fundmi të sistemit elektronik brenda OSHP-së tani, ekziston një mekanizëm që gjeneron automatikisht rekomandim të emrave të tre ekspertëve për çdo rast që merret në shqyrtim nga paneli shqyrtues. Nga kjo listë, administrata e OSHP-së emëron ekspertin më të përshtatshëm për të kryer vlerësimin e nevojshëm. Në raportin e kaluar, D+ kishte rekomanduar të ndryshohet forma e caktimit të ekspertëve<sup>41</sup>. D+ ka rekomanduar se sistemi elektronik brenda OSHP-së, duhet në mënyrë automatike të vendos për ekspertin që do ta shqyrtojë lëndën e caktuar, gjë që do të rriste transparencën e punës së OSHP-së. Mirëpo, ky rekomandim nuk është marrë parasysh.

OSHP vlerëson se përzgjedhja në mënyrë manuale e ekspertit nga administrata pas rekomandimit të tre emrave nga ana e sistemit vazhdon të bëhet për disa arsye. Këtu përfshihet tendenca për raste të përsëritura, skenarë ku një eksperti mund t'i mungojë ekspertiza e kërkuar profesionale, domosdoshmëria për një ekspert tjetër dhe raste kur kompleksiteti i rasteve kërkon fleksibilitet,

**Caktimi i ekspertëve në OSHP bëhet në mënyrë gjysmëautomatike**

37 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës paragrafi 1, neni 111 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

38 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 113, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-068 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

39 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës paragrafi 1, Neni 114 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

40 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 114, përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

41 Raporti monitorimit të OSHP-së nga D+ [janar - qershor 2023], ([https://dplus.org/wp-content/uploads/2023/09/18-09-23\\_Organi-Shqyrtues-i-Prokurimit-Monitorim-dhe-rekomandime.pdf](https://dplus.org/wp-content/uploads/2023/09/18-09-23_Organi-Shqyrtues-i-Prokurimit-Monitorim-dhe-rekomandime.pdf))

duke shmangur kështu kufizimet e panevojshme dhe duke kursyer kohë. D+ qëndron të jetë e përkushtuar ndaj idesë që modifikimi i procesit të përzgjedhjes së ekspertëve veçanërisht duke sugjeruar vetëm një kandidat përmes sistemit, do të kontribuonte në rritjen e transparencës brenda kësaj organizate. Ky ndryshim në sistem do të duhet të përcillej edhe me mundësinë e ndryshimit të emrit të ekspertit i cili rekomandohet nga sistemi, gjithmonë i shoqëruar me një dokument-arsyetim nga administrata se pse ka ndodhur një ndryshim i tillë.

Sa i përket angazhimit të ekspertëve shqyrtues, gjatë periudhës monitoruese, D+ ka vërejtur se ekspertizat në shumicën e rasteve janë lëshuar duke respektuar afatin ligjor. Megjithatë, disa probleme janë evidentuar duke përfshirë rastet kur mendimet e ekspertëve nuk arrijnë të adresojnë të gjitha pretendimet e shqyrtuara dhe ku ka mangësi në ofrimin e arsyesimit të detajuar brenda opinioneve të lëshuara. Për ankesën e operatorit ekonomik Solvit Sh.P.k, ndaj autoritetit kontraktues Komuna e Prishtinës, për aktivitetin “Furnizim me tabela të menqura (smart) për institucionet arsimore në Komunë të Prishtinës”, paneli shqyrtues ishte detyruar të angazhojë në dy raste ekspertë shqyrtues. Herën e parë eksperti shqyrtues kishte rekomanduar që ankesa të refuzohej si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës. Por, paneli shqyrtues, mendimin e ekspertit shqyrtues e kishte hedhur poshtë nën arsyetimin se nuk është hartuar në përputhje me nenin 114 paragrafin 1, lidhur me nenin 113 të LPP-së<sup>42</sup>, por duke mos dhënë detaje se në cilën pjesë nuk janë respektuar këto nene.

**Në përgjithësi,  
opinionet e  
ekspertëve  
publikohen  
brenda afateve  
ligjore**

Në anë tjetër, paneli ia dha besimin e plotë ekspertizës së dytë për të njëjtin aktivitet të prokurimit. Eksperti kishte rekomanduar që ankesa të miratohet si pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në një rast tjetër, për aktivitetin e prokurimit ‘Furnizim me material laboratorik’<sup>43</sup> i inicuar nga autoriteti kontraktues Komuna Gjilan, eksperti shqyrtues nuk e kishte përfillur ankesën e operatorit ekonomik ankuës i cili supozonte se operatorit ekonomik i rekomanduar për kontratë kishte ofertuar me aparatura/materiale jo relevante. Paneli shqyrtues kishte dal kundër mendimit të ekspertit, pasi i njëjti nuk kishte dhënë sqarime të detajuara dhe ankesën e kishte cilësuar si të pabazuar. Paneli shqyrtues konstatoje se arsyetimi i ekspertit është i mangët pa dhënë detaje të mëtutjeshme, kështu që ky veprim bie ndesh me nenin 108/A, pika 8<sup>44</sup> të LPP-së, i cili saktëson se refuzimi duhet të arsyetohet në detaje. Në të njëjtën kohë, paneli konstatoi se eksperti shqyrtues nuk kishte ofruar argumente, fakte dhe dëshmi bindëse që të bindin panelin shqyrtues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar komform Dosjes së Tenderit dhe specifikimeve teknike të detyrueshme. Një rast i ngashëm ishte edhe lënda 366/23<sup>45</sup>, ku dy ekspertë shqyrtues dolën me rekomandime të kundërta njëra me tjetrën në periudhën prej 30 ditësh.

Në një rast tjetër, aktiviteti i prokurimit ‘Furnizim me gjenerator’ i inicuar nga Komuna Gjilan, (lënda 212/23<sup>46</sup>), eksperti i jashtëm nuk kishte trajtuar në tërësi pretendimet e palës ankuese, por kishte vlerësuar se ankesa është e pabazuar. Ky veprim kishte shtyrë panelin shqyrtues që të dal me vendim që ankesa e GOE ankuës “Eor Group” sh.p.k & “Contanti Generators” të aprovohet si e bazuar, dhe që aktiviteti i sipërhënuar të kthehet në rivlerësim.

<sup>42</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Neni 114 paragrafi 1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

<sup>43</sup> Numri i vendimit 179/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/f75e57ad-c8f0-ed11-b5b8-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

<sup>44</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Neni 108/A i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/068 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

<sup>45</sup> Numri i vendimit 366/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/f75e57ad-c8f0-ed11-b5b8-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

<sup>46</sup> Numri i vendimit 212/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/bec51d99-092a-ee11-b5ba-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 31 dhjetor 2023)

# Përfundime

## DUKE U BAZUAR NË MONITORIMIN E DYTË GJASHTË MUJOR, OSHP-JA VAZHDON TË PËRBALLET ME DISA SFIDA TË RËNDËSISHME, DUKE PËRFSHIRË:

### Vonesat në vendimmarrje

Një çështje e vazhdueshme me të cilën vazhdon të përballlet OSHP-ja është mos respektimi i afatave ligjore për publikimin e vendimeve. Ky problem i vazhdueshëm, jo vetëm që ndikon në efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të prokurimit publik, por gjithashtu minon besimin e palëve të interesuara në aftësinë e OSHP-së për të zgjidhur ankesat në kohë dhe në mënyrë të drejtë.

Një nga pasojat kryesore të këtyre vonesave është zgjatja e aktiviteteve të prokurimit publik. Kur ankesat nuk adresohen menjëherë dhe vendimet nuk publikohen brenda afatit të përcaktuar, pengohet rrjedha e proceseve të prokurimit. Pasiguri të tilla prekin të gjitha palët e përfshira, duke përfshirë autoritetet kontraktuese dhe OE, dhe potencialisht mund të rezultojë në vonesa të projekteve, pengesa financiare dhe humbje të mundësive të zhvillimit ekonomik.

Vonesat mund të jenë veçanërisht të dëmshme në rastet kur aktivitetet e prokurimit kanë implikime sezonale ose të ndjeshme ndaj kohës. Për shembull, tenderët që lidhen me mirëmbajtjen e rrugëve gjatë dimrit ose verës, ose furnizimi me mallra për ngjarje të caktuara, mund të kenë mundësi të kufizuara. Vonesat në vendimmarrje mund ta bëjnë qëllimin e këtyre aktiviteteve të bëhet i vjetëruar ose më pak të rëndësishëm, duke ndikuar negativisht në

efikasitetin dhe kosto-efektivitetin e projekteve.

Për më tepër, tejkalimi i afatit ligjor prek integritetin dhe reputacionin e OSHP-së si organ i pavarur dhe i paanshëm përgjegjës për zgjidhjen e kontesteve të prokurimit. Ky dështim për të përmbushur afatet mund të bëjë që palët e interesuara, duke përfshirë OE, AK-të dhe publikun e gjerë, mund ta perceptojnë OSHP-në si joefikase ose të paafte për të përmbushur mandatin e saj, duke çuar në mungesë besimi në këtë institucion.

### Mungesa e konsistencës në vendime

OSHP-ja përballlet me një sfidë të madhe me mos konsistencën në vendime, duke dëmtuar besueshmërinë e saj si institucion i caktuar për shqyrtimin e ankesave të prokurimit publik. Kjo mos konsistencë ngre shqetësime për drejtësinë dhe paanshmërinë e procesit të rishikimit duke i bërë palët e interesuara veçanërisht OE-të, të përballen me rezultate të paparashikueshme dhe të ndryshme, duke nxitur kështu pasiguri.

### Vendimet pa konstatim nga paneli shqyrtues

Paqartësia në vendimet e OSHP-së paraqet sfidë për operatorët që përpiqen të kuptojnë kriteret e aplikuar në vlerësimin e ankesave të tyre. Kjo mungesë qartësie mund

t'i dekurajojë OE-të që të ndjekin ankesat legjitime për shkak të perceptimeve të njëanshmërisë ose paqartësisë në proces.

Për më tepër, kur OSHP-ja përmbahet nga marrja e një vendimi përfundimtar për ose kundër një anese për OE, duke e shtyrë vendimin te gjykatat kompetente, kjo minon besimin e publikut në aftësinë e OSHP-së për të mbështetur transparencën dhe llogaridhënien në prokurimin publik.

### Angazhimi i ekspertëve

Funksionimi efektiv i OSHP-së mbështetet shumë në ekspertizën e ekspertëve të saj shqyrtues, veçanërisht në fusha të specializuara si TI dhe mjekësia. Për të siguruar që OSHP-ja mund të trajtojë ankesat komplekse dhe teknike me saktësi dhe aftësi, është thelbësore që të adresohet çështja e angazhimit të ekspertëve shtesë dhe zgjerimit të ekspertizës.

### Mungesa e transparencës

Transparenca në punën e OSHP-së ka ende nevojë për përmirësim. Kjo përfshin transmetimin e të gjitha seancave dëgjimore në internet, mbajtjen e linqeve për qasje publike, publikimin e ankesave dhe vendimeve në një format të lexueshëm në faqen zyrtare të internetit dhe sigurimin e dokumentacionit të duhur, përfshirë këtu edhe publikimin e kërkesave të AK-ve për diskualifikim të OE-ve.

# Rekomandime

BAZUAR NË GJETJET SIPAS KËTIJ RAPORT, D+ REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME PËR TË PËRMIRËSUAR PERFORMANCËN E OSHP-SË:

1

## Përmirësimi i databazës së të dhënave:

Përmirësimi i bazës së të dhënave të OSHP-së për të lehtësuar kërkimin e lehtë të vendimeve për çështje specifike, duke nxitur vendimmarrje të qëndrueshme. Një infrastrukturë e fuqishme e TI-së do të optimizojë menaxhimin e rasteve, do të sigurojë ruajtjen dhe rikthimin e sigurt të dokumenteve, do të eliminoj gabimet në databazë dhe ngritjen e standardeve të transparencës dhe qasjen në të dhëna, duke çuar në transparencë të përmirësuar dhe operacione të thjeshta për OSHP-në.

2

## Publikimi i vendimeve të pritshme:

Të përpilohet një listë e kërkesave të zakonshme nga OE dhe të publikohen në mënyrë proaktive vendimet e pritshme për këto kërkesa. Kjo qasje pro aktive do t'i sigurojë OE-së njohuri të avancuara dhe potencialisht do të zvogëlojë numrin e ankesave. OSHP-ja duhet të punojë drejt vendosjes së kritereve të mirëpërcaktuara dhe uniforme për vendimmarrje në raste të ndryshme. Ky stan-

dardizim do të thjeshtojë procesin, duke promovuar një qasje më të qëndrueshme të vendimmarrjes dhe do të sigurojë drejtësi në adresimin e ankesave të marra.

3

## Eliminimi i vendimeve pa përfundim:

Zbatimi i rreptë i kompetencave dhe funksioneve ligjore, duke eliminuar praktikën e dhënies së vendimeve pa konstatim përfundimtar. Ky zotim siguron qartësi dhe besueshmëri në rezolutat e OSHP-së.

4

## Përzgjedhja e automatizuar e ekspertëve:

Të modifikohet sistemi për të gjeneruar emrin e një eksperti të vetëm në vend që të ofrohen tre rekomandime. Ky rregullim do të rrisë transparencën, shmangë favorizimin, dhe rrit llogaridhënien, duke marrë parasysh rolin që luajnë ekspertët në procedurat e OSHP-së.

5

## Vlerësimi i performancës së ekspertëve:

Të vlerësohet rregullisht performanca dhe cilësia e punës së ekspertit për të siguruar profesionalizëm dhe paanshmëri, veçanërisht në rastet që përfshijnë performancë joadekuate. OSHP-ja duhet të ketë prioritet rekrutimin e ekspertëve të brendshëm, dhe uljen e rekrutimit të ekspertëve të jashtëm. Fusha në të cilën OSHP duhet të ketë prioritet është ajo e TI-së dhe pajisjeve mjekësore, për të adresuar rastet me saktësi dhe efikasitet më të lartë. Zbatimi i programeve të trajnimit dhe mundësive për mundësi zhvillimi profesional mund të rrisë nivelin e ekspertizës brenda OSHP-së dhe të sigurojë konsistencë më të mirë.

6

## Eliminimi i praktikës 'Ankesa pjesërisht e bazuar':

Të inkurajohen ekspertët shqyrtues që të mos i kategorizojnë rastet si pjesërisht të bazuara për të thjeshtuar procesin e vendimmarrjes për Panelin Shqyrtues pasi është në kundërshtim me ligjin.



**7**

## Publikimi i gjobave të vendosura ndaj autoriteteve kontraktuese:

OSHP të bëjë publike listën e autoriteteve kontraktuese që janë gjobitur për shkak të mos respektimit të vendimeve të OSHP-së. Kjo masë do të dekurajonte shkeljet e ardhshme.

**8**

## Kërkesat për diskualifikim:

Të bëhet publike kërkesa për diskualifikim që vjen nga AK për OE. Me publikimin e kërkesave për diskualifikim, do të kishte një pasqyrë të hapur se sa është numri i kërkesave, dhesa është koha që OSHP-së i duhet të marrë vendim.

**9**

## Qasja në dokumente:

Të ruhen të gjitha dokumentet thelbësore, duke përfshirë vendimet, apelimet dhe raportet e ekspertëve, në një format elektronik të lexueshëm nga kompjuteri për qasje të përshtatshme nga publiku. Ky hap rrit ndjeshëm transparencën dhe përgjegjëshmërinë. Publikimi i raporteve gjithëpërfshirëse vjetore që përmbajnë informacione në lidhje me autoritetet kontraktuese që nuk kanë respektuar vendimet e OSHP-së, performancën, statistikat për pjesën e mbetur, rastet e reja dhe rezultatet e tyre. Kjo do t'u mundësojë palëve të interesuara të vlerësojnë efektivitetin dhe efikasitetin e OSHP-së.

**10**

## Transparenca:

Të bëhet transmetimi i drejt-përdrejtë i të gjitha seancave dëgjimore, të jenë të qasshme linqet për seancat e mbajtura në çdo kohë, publikimi i ankesave dhe vendimeve të bëhet në një format të qartë dhe të lexueshëm në faqen zyrtare të internetit. Këto veprime rrisin transparencën dhe qasjen e publikut në procedurat e OSHP-së. Lejimi i palëve të interesuara të kenë mundësinë për të dhënë komente duke e publikuar draft rregulloren në ueb faqen e OSHP-së. Kjo qasje gjithëpërfshirëse siguron hapje në ndryshimet rregullatore dhe inkurajon angazhimin e palëve të interesuara.

